

VENDIM
Nr. 762, datë 16.9.2015

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËR PËRCAKTIMIN E KONTRIBUTIT
KOMBËTAR TË PIKËSYNUAR KUNDREJT ARRITJES SË OBJEKTIVIT TË
KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Pikësnuar (INDC) për Shqipërinë për arritjen e objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, për mbajtjen e tempe-raturave nën 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit të dorëzojë, brenda datës 1 tetor 2015, dokumentin që përcakton Kontributin Kombëtar të Pikësnuar (INDC) në Sekretariatin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama